



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI

Nr. 561/p Prot.

Tiranë, më 17.03 2026

VENDIM

Nr. 40 dt. 17.03 2026

**“PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.7 DATË 13.01.2026 TË SENATIT
AKADEMIK, MIRATIMIN E MARRËVESHJES DHE NISJES SË PROCEDURAVE
PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT BACHELOR NË “DIETOLOGJI”,
ME DIPLOMË TË DYFISHTË, MIDIS UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË
TIRANËS, FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT DHE UNIVERSITETIT
TË KATANXAROS “MAGNA GRAECIA” ITALI”**

Mbështetur në nenin 3, 38 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Vendimin nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në nenin 7, 20, 73 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 54 dhe 55 të Rregullores së UST-së, shkresën nr. 76/2 prot., datë 12.01.2026 prot., datë 07.01.2026 të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit “Nisja e procedurave për hapjen e programit të ri të studimit në Bachelor në “Dietologji” me diplomë të dyfishtë në bashkëpunim me Universitetin e Katanxaros “Magna Grecia” Itali, në FSHR”, Senati në mbledhjen e datës 17.03.2026,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.7 datë 13.01.2026, “Për nisjen e procedurave për hapjen e programit të përbashkët “Bachelor” në “Dietologji”, me diplomë të dyfishtë, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit dhe Universitetit të Katanxaros “Magna Grecia Itali” dhe miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit”.

2. Miratimin e marrëveshjes së programit të përbashkët me Universitetin e Katanaxaros “Magna Graecia” Itali, të rishikuar dhe ndryshuar (bashkëlidhur vendimit).
3. Miratimin e nisjes së procedurave për hapjen e programit të përbashkët “Bachelor” në “Dietologji” me diplomë të dyfishtë midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit dhe Universitetit të Katanaxaros “Magna Grecia Itali”.
4. Miratimin e pagesave për profesoratin e ftuar për mbulimin e shpenzimeve të transportit, fjetjes, dietën ditore si dhe pagimin për orë mësimdhënie sipas akteve rregullatore dhe marrëveshjes së miratuar.
5. Ky Vendim i përcillet Bordit të Administrimit.
6. Ky Vendim i përcillet për njohje dhe zbatim FSHR-së, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
7. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA

